



ALI NIVICA DHE
BEQAJT E NIVICËS

Sedat Beqaj & Veli Hodaj



NGA KURVELESHI TEK
ATA PËRTEJ OQEANIT

Faqe 2 Klodoaldo Lamçe

Faqe 4

JETA E NJERIUT ËSHTË NJË HUMBJE E PANDËRPRERË! (Përkujtimore në ditën e lindjes)

Nga Neki Çako

Natasha ! Ah,! Natasha, sa do të donim sot që të të uronim për ditën tënde të lindjes, por fatkeqësisht të themi u prehsh në paqe, sepse sëmundja e pashërueshme ta mori jetën. Ti ishe një shpirt i pastër, i bukur, me plot ëndërra për jetën! Ti e dashuroje jetën, i qeshje asaj, ishe vitale e plot nur. Jeta prej jetimeje, të kishte detyruar që, shumë gjëra t'i përjetoje si e tillë, ku dhimbja për nënën, ta shtypte vazhdimisht kraharorin dhe malli të mblidhej si lëmsh në fyt. Para sysh, më del jeta e saj, plot sakrificë, një jetë e mbushur me dinjitet urtësi dhe krenari. Ajo ishte njeriu i urtë që dinte të përballonte çdo sfidë dhe të triumfonte mbi të keqen Ti u rrite me mungesën e nënës, por munde t'ja dilje, të rriteshe, të shkolloheshe dhe të krijonje familjen tënde. Natasha Çune Bega erdhi në jetë, në një fillim viti, lindi më, 25.01.1967, duke sjellë shumë gëzim, në familjen e saj të thjeshtë, e punë bërë, mirëpo fati nuk i buzëqeshi deri në fund, sepse më pas, ajo u nda nga jeta në fillimin e asaj vere përvëluese, ku kolera e covidit kishte pllakosur kudo. Ajo vdiq më, 26.06.2019 në Athinë, duke hidhëruar pa masë, së pari gjirin e familjes së saj të shkëlqyer që ajo krijoi, të cilën e rrethoi me dashurinë e pakufishme të shpirtit të saj, e mbrojti dhe çoi përpara me përkushtimin e një nëne shëmbullore, por gjithashtu edhe të afërmit, miqtë e dashamiresit e saj bashkëudhëtarë të jetës, si dhe të gjithë atyre që e njohën, e vlerësuan, e nderuan dhe e respektuan, për personalitetin, për

karakterin edhe për cilësitë e saj të larta njerëzore. Po ja në mbrëmjen e ditës së djeshme lexoj diku një ikje, një dhimbje, një largim të parakohshëm. Lexoj dhe nuk besoj, një status që kishin bërë në fcb,! Një lajm i hidhur dhe një ditë e trishtë. Urtësia, qetësia, dashuria për njerëzit dhe sakrifica për të bërë vetëm mirësi. Qofsh në dritë, . E gjithë jeta e saj u zhvillua dhe mbeti e fiksuar si një vijë në ngritje, pa përthyerje a rrudhosje, e mbushur me përpjekje të vazhdueshme, me mund e djersë për të arritur lartësitë, për të krijuar meritueshëm figurën e njeriut të mirë, me mirësinë si tipar themelor të karakterit e të personalitetit që e shfaqte në çdo gjest, e marrdhënie me të tjerët. Ajo la në trashëgim edhe figurën e njeriut të ndershëm, sepse ndershmërinë e kishte në ADN-në e saj, të kultivuar nga një familje e ndershme dhe të rrënjësuar në ndërgjegjen e saj qytetare me këndvështrimin që kishte për jetën pa vese, pa lakmi, pa grykësi, pa keqdashje për askënd e për asgjë. Sëmundja e rëndë e mposhti, duke lënë të pikëlluar bashkëshortin e saj, Demirin dhe dy fëmijë



si yje, Denisi dhe Klevisa, që sot operojnë në fusha të ndryshme të jetës.


Ja si do të shprehej djali i xhaxhait, Halili, në një postim në rrjetet sociale në një përvjetor të kujtimit të saj. "Unë motër, do të kujtoj sa të jem gjallë, sepse do të kujtoj hallet që nëna jote



të la 12 vjeç. Dhe ç'të besosh më, në atë Zotë që vuri dorën dhe ty të zgjodhi. Kaq shumë për nënën..., për Katen, të kish marrë malli! Pse fatin tënd si të nënës e shkroi? Pse të ra fati, kaq për lumë, pranë saj, kaq shpejtë për të shkuar. Po, ku të çoi nga shoqet ajo sëmundje e mallkuar. Dhimbja ishte aq e madhe sa njeriu ngelet ngushtë e humb besimin edhe në zot, duke e ditur se jetën na e ka shkruar ai, dhe tek ai do kthehemi! Qoftë e lehtë balta për ty, e mira Natasha (Tashe) Çune Bega.. Si s'mendove, si munde dhe i le fëmijët me të njejtin fat, siç ju la edhe nëna juve..Prehu e qetë në prehrin e nënës, që ju la të vogla dhe përballuat jetën dhe u bëtë fëmijë model.. Do jesh e pa harruar në zemrat tona".Eh'!

Kjo është jeta?. Humbje! Humbje e kohës, e vëndeve e rinisë e kështu me radhë do të mund të numëronim gjithçka.! Por humbja mund të jetë edhe një formë e fshehtë e fitores. Ç'fitohet duke humbur? Kjo nuk është edhe aq e lehtë të njihet. Në fund humb jetën dhe fiton vdekjen. Me tej, nuk dimë ç'bëhet! Por njeriu vdes kur ai harrohet. Ndaj le të ndajmë kujtimet dhe historitë më të mira të personit tuaj të dashur dhe t'i ruajmë ato për gjithmonë!

E pa harruar Natasha!
Emri jot u lartësoftë, në kopështet e bukura të parajsës!



ALI NIVICA DHE BEQAJT E NIVICËS

PJESË NGA LIBRI

Me autor, Sedat Beqaj & Veli Hodaj

PROLOG

Sociologë, psikologë a psikanalistë të shquar, kanë vërtetuar se karakteret e njerëzve formohen a ndikohen, jo vetëm nga kushtet familjare e shoqërore, ku rriten e kalojnë jetën, por edhe nga mjedi- si apo gjeografia, ku u ka rënë fati të jetojnë. Këto rrethana e bëjnë të veçantë jo vetëm fizikun a pamjen e jashtme të tyre, por edhe psikologjinë e shpirtin e gjithsecilit. Bie fjala, nëse shikon një të panjohur, me cilësi të veçanta, me trup të lartë, me ecje prej atleti, pa mish të tepërt në trup, me vështrim zhbirues, etj. Menjëherë mëndja të shkon se ky është malësor, lab, kurveleshas...Ndjesia nuk është e gabuar. Po, ai është malësor, lab, kurveleshas, sepse, veç të tjerash, terreni ku ka lindur e është rritur, e ka bërë të tillë. Ka jetuar në një gjeografi, ku fati ka qënë gjithnjë në zgrip. Por ka jetuar... A e keni parë atë dafinën në faqen e thiktë, në humnerën e ububushme, se si i është ngjitur shkëmbit? Me rrënjët e saj, delikate në dukje, ajo gjen veç një të çarë në faqen e frikshme të shkëmbit dhe kaq i mjafton, që, në mënyrë të pabesueshme, të rritet plot jetë e shëndet. Ç'të rritur se..! Ajo është më e bukura e më erëmira e dafinave që ka bota. Se është rritur me sakrificë...Na pëlqen ta krahasojmë me jeten dhe sakrificën e kësaj dafine, jetën e banorëve të trevës së Kurveleshit, që kur ka lindur njeriu i parë e deri më sot. Përjetësisht jeta këtyre anëve, ka patur një histori të vrullshme në një gjeografi të aksidentuar.

KURVELESHI

Historia e Kurveleshit nuk mund të bëhet, vecse në kuadër të historisë së Labërisë, pjesë e së cilës është dhe ka një vend të veçantë në historinë e kombit. Falë kushteve të favorshme për mbrojtje, Kurveleshi ka qënë vatra kryesore e qëndresës në Labëri. Georg Hahni e ka quajtur këtë krahinë "një akropol të paarrishëm prej armiqve". Shpirtin e kundërshtimit të së keqes, ngado që ka ardhur, nuk arriti ta shuante as gjysmëshekulli i diktaturës, as varfëria dhe rënia morale, që e pllakosi Kurveleshin në vitet e tranzicionit. "Ta fshehësh apo ta harrosh prejardhjen tënde, thotë Prof. Rahmi Mehmushi, është një gabim i pafalshëm. Kudo që ta kenë hedhur valët e jetës, kurveleshasi duhet të krenohet për prejardhjen e tij dhe ta dojë edhe më shumë vëndlindjen, njerëzit e saj, zakonet, traditat fisnike, për të cilat na kane lëvdur edhe të huajt. Dhe jo vetëm të krenohen, por edhe të përpiqen t'ia çojnë emrin më lart me sjelljet dhe veprimet e tyre, të bëjnë diçka të mirë për këtë krahinë, në mënyrë që të mos mbetet peng i tranzicionit."(R. Memushi: Historiku

i Kurveleshit) Ka qasje, kur, nga lodhja, shoqëria i flak tutje heronjtë dhe historinë, ashtu si një femijë hedh poshtë librat ditën e fundit të shkollës. Por këto çaste marrëzie nuk zgjatin shumë. Shoqëria ka nevojë për përvojat e kaluara dhe prandaj u kthehet atyre për të ndrequr shformimet e për të gjetur rrugën e duhur të së ardhmes. Banorët e kësaj krahine, përsa i përket origjinës së tyre, duke u nisur nga të dhënat arkeologjike, historike dhe linguistike, janë autoktonë në trojet ku banojnë. Fisi i fundit ilir, që ka jetuar në këtë krahinë, ka qënë ai i Korvesejve, prej të cilit ka prejardhjen Kurveleshi. Sufflay, në një dokument të kohës, publikuar në librin e tij, flet për një kryengritje, që ka shpërthyer kundër turqve në vitin 1481, ku ndër të tjera, shkruan: "Popullsia e këtyre malësive përbën më shumë se 50 fshatra, ku dalloheshin krahina si njësi etnike më vete, me treva të vecanta, si: himarjotët, grisejtë dhe korvesejtë". (Sufflay, "Serbët dhe shqiptarët", Tiranë, 1926) Përpara korvesejve, në lashtësi, krahina që sot quhet Labëri, quhej Kaoni dhe banorët e saj, kaonë. Kaonët kanë qënë një nga fiset e Ilirisë jugperndimore, që përmenden për herë të parë prej Hekateut, dijetar grek I shekullit V. p. e.r. në librin e tij, "Udhëtime rreth botës". Ndërsa Skilaksi, bashkëkohës i Hekateut, thotë se: "Pas ilirëve vijnë kaonët, pas kaonëve vjen fisi i Thesprotëve" Kaonët i përmend edhe Tuqididiti, në çerekun e fundit të shek. V. p.e.r., si aleatë të spartanëve dhe ambrakasve kundër Athinës. Emri i kaonëve dhe i Kaonisë, del te të gjithë autorët e mëvonshëm grekë dhe romakë, duke përfunduar me Stefan Bizantinin, i cili jep hartën etnike të Epirit, rreth shek. VI pas Krishtit, para se fiset të zhduken përgjithmonë. Pa diskutim, Korvesejtë janë pasardhës të fisit të Kaonëve. Sipas Kristobul, historian grek i shek.XV, i cili përshkruan fushatën e vitit 1459, të Sulltan Mehmetit II, kundër vendeve përballë Korfuzit, thotë se në fillim ilirët e kësaj treve quheshin mahaonë, (Kaonë). Emri Kaoni, që më vonë u shua dhe nuk përdorej më, u ruajt në folklor. Vargjet e një kënge të vjetër të Himarës (Labërisë), thonë: "Ata dinë ç'trima jemi/që në kohë të Kaonisë/". Por edhe te mbledhësi i hershëm i folklorit, Spiro Dine, përmendet dy here emrin Kaoni. Kur përmendim sot emrin Kurvelesh, kemi parasysh pesë fshatrat që përbëjnë këtë njësi administrative: Lekdush, Progonat, Gusmar, Rexhin dhe Nivicë. Të pesë fshatrat, si pesë gishtrinjtë e dorës, në një vendosje gjysmërrethore, janë ngritur në prehër të maleve. Aleatë të përjetshëm me malet, në të mirë e në të keq! Të pesë fshatrat gjirin ia kanë hapur diellit të mëngjesit, që me rrezën e parë, ngroh, pemët, drurët, gurët, arat, barin, lulet, pyjet, shpirtrat e banorëve të këtyre anëve... Para Luftës së Dytë Botërore, nocioni gjeografik dhe administrativ, Kurvelesh, ka qënë më i gjerë se kaq. Kurveleshi përbëhej nga Kurveleshi i Sipërm dhe ai i Poshtëm. Gjithësej 15 fshatra, që kanë bërë pjesë si njësi administrative, herë në Pashallëkun e Delvinës, herë në atë të Vlorës. Në kohët e lashta, deri në mesjetë, Kurveleshi ka bërë pjesë në krahinën e Himarës, e cila përmblidhte 50 fshatra,

deri në Tepelenë. Tradicionalisht Kurveleshi ishte i përbërë nga këto fshatra: Nivicë, Rexhin, Gusmar, Progonat, Lekdush, Bëncë, Shtëpëz, Picar, Humelicë, Kolonjë, Kaparjel, Golëm, Vërmik, Kallarat, Kuç, Fterrë, Çorraj, Borsh. (AQSH, nr. 311, viti 1929, Dosja 1,).

Mendimet që qarkullojnë nga njerëz të ndryshëm se rregjimi komunist e shpërbëri Kurveleshin, fshatrat e të cilit i kaloi në administrimin e katër rretheve: Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, Tepelene, se mos Kurveleshi, po të ishte i bashkuar mund ta "trovoliste" rregjimin, duken infantile. Rregjimi i asaj kohe kishte mundësinë dhe forcat për të mposhtur çdo kundërshtim. Aq më tepër që Kurveleshi, si krahinë, kishte dhënë një kontribut si rrallë krahina gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe rregjimi e mbante si "kështjellë të kuqe". Shkaku përse u shpërbë Kurveleshi, është racional dhe shumë i arsyeshëm. S'mundej, me që bie fjala, Vërmiku, Kuçi, Bolena apo Kallarati, të vinin në Gusmar, si qendër nënprefekturë, për çdo problem administrativ. Theksojmë se për ta bërë këtë, u duhej të bënin nga katër deri në pesë orë udhë më këmbë. Në dimër është pothuaj pamundësi. Fshatrat më lart iu atashuan Vlorës. Çorraj, Fterra dhe Borshi kaluan me Sarandën, ndërsa Shtëpëzi, Humelica, Kolonja, Golëmi dhe Kaparjeli, u lidhën me Gjirokastrën. Nivica, Rexhini, Gusmari, Progonati dhe Lekdushi mbetën me Tepelenë Historia e kësaj krahine dëshmon për shumë ngjarje të rëndësishme duke u vënë përballë rrebesheve të kohës. Por ka qëndruar me dinjitet. Pa e mekur vështrimin, pa e thyer gjurin. Kurveleshi është kocka e Labërisë dhe na vjen mirë të perifrazojmë Prof. Dr. Rexhep Qosen, kur thotë: „Sa herë ka hall Shqipëria, e para është Labëria.“ (Patjetër kocka- Kurveleshi !). Dëshmohet nga gojëdhënat, folklori, dokumentet arkivore, monumentet historike, gjetjet arkeologjike etj. se Kurveleshi, si gjithë Labëria, ka pësuar mbi kurriz goditje tronditëse, djegje, shkatërrime nga të gjitha pushtimet. Por më mizoret kanë qënë ato të v. 1913- 1914, ku andartët grekë, me urë zjarri në dorë, dogjën Kurveleshin. Këtë dhimbje, e pasqyron edhe kënga e popullit, kur thotë: " O Kurveleshi me derte\ Qysh duron për ato lezete,\ Për ato odat me qelqe\ T'i dogji e t'i zhuriti\ Veni-

zellua nga Gjiriti...“(Manxhar Taka “Drithërimat e Katërbëdhjetës“ E tillë ishte edhe mësymja fashisto- naziste e Luftës së Dytë Botërore, ku Kurveleshi iu kundërvu pamëdyshje bishës nazi- fashiste, por pagoi kosto të lartë. Gjaku i shumë bijve të saj u vu në altarin e lirisë. Kurveleshi doli ballëlart nga kjo luftë dhe s’kish si të ndodhte ndryshe. Ai ballëndritur kishte dalë nga përplasja me armiqtë e Shqipërisë në çdo kohë. Emrin e ka të shkruar me shkronja të arta në historinë e Shqipërisë. Një goditje tjetër, e dhimbshme, trishtuese, e pakuptimtë, ishte ajo e pas viteve 1990. Pati një shpërngulje masive të familjeve kurveleshase, një boshatisje biblike të fshatrave, duke mos i kuptuar drejt hapësirat e pafundme që të jep demokracia. Të abuzosh me të është e dëmshme. Sidoqoftë ikjet, braktisjet, largimet nga vendlindja, janë dhimbje. Familje të tëra, me kokën pas, për një jetë më të mirë, u vendosën kryesisht në Tiranë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë apo edhe jashtë atdheut, si: në Greqi, Itali, Gjermani, Angli e SHBA e deri në Australinë e largët. Kudo që shkuan, punuan me dinjitet dhe përmes vështirësive të panumërta, ruajtën krenarinë dhe u integruan në qytetërimet ku vajtën, si të barabartë e dinjitozë Tani, shumë prej të emigruarve, i kanë kthyer sytë nga vendlindja. Kjo, për fat të mirë, nga që po krijohen kushtet infrastrukturore në krahinë. Është si një ëndërr e bukur, kur, pas asfaltimit të rrugës Tepelenë- Nivicë, ka nisur një ndërmarje e gëzuar e plot shpresë për të ardhmen, ajo e hapjes dhe asfaltimit të rrugës Gusmar- Kuç-Kudhës-Qeparo- Himarë. E pabesueshme, por e vërtetë! Kjo rrugë turistike, me parametra maksimale, do të lidhë Kurveleshin me Himarën dhe fshatrat rreth saj. Për 40 minuta, nga qendra e Nivicës, mund të shkosh dhe ta pishë kafënë në Spile dhe e kundërta. Është një lidhje shumë e dëshiruar, si nga kurveleshasit, ashtu edhe nga bregasit. Jemi një gjak, një gjuhë, një ADN dhe kemi një atdhe: Shqipërinë. Kemi të njëjtat karakteristika antro-

pologjike dhe të njëjtin karakter. Me djem e burra “që të marrin gjak në vetull“e vajza e nuse të bukura, si të stërpikura me dritë hëne. Jemi fis kaonësh! Vetëm dy shekuj më parë Himara ka qënë kryeqendra e Labërisë. Pse të mos bëhet edhe tani? Kemi qënë gjithnjë bashkë. Familje të shumta kurveleshase kanë miqësi të ngushtë me ato të Bregut. Shumë familje në Himarë dhe fshatrat e Bregut, janë me prejardhje nga Kurveleshi, si: Rexhajt nga Rexhini, Bollanaj apo Kokaj nga Prognati, etj. Edhe në vitet e diktaturës, nuk i jemi ndarë njeritjetrit. Kemi përjetuar të njëjtin fat. Gjatë verës, tufa bagëtish nga Himara dhe fshatrat e saj, veronin në kullotat malore të Kurveleshit, ashtu si në dimër bagëtitë e Kurveleshit zbrisnin në bregdet. Është shumë e afërt dita, kur prodhimet e mrekullueshme blektorale, si: mishi, djathi, gjalpi, gjiza, qumështi, do të furnizojnë, me kosto të ulët, tregun turistik të Bregut. Ashtu si agrumet, ulliri dhe vaji i ullirit, do të zënë vend lehtësisht në menunë e tavolinës kurveleshase. Më shumë se kaq! Himarë e Kurvelesh,(Labëri) janë një trup e një shpirt dhe na vjen mirë, të citojmë Bajronin, poetin anglez të shek. XIX, që, kur vizitoi Himarën dhe Labërinë, i mahnitur, tek poema e tij madhore, “Çajld Haroldi”, shkroi: “ Të rreptë bijtë e Shqipes!” Vetitë nuk u mungojnë, por të ishin më të arrira. Kush e duron si ata mundimin e luftës!? Shkëmbijtë e tyre s’janë më të patundur se ata, Në rast rreziku dhe nevoje! Ç’armiq për vdekje, por sa miq besnikë! Kur besa a nderi i thërret të derdhin gjakun, Si trima turren ku i thërret i pari i tyre...

TAKIM MES MIQSH



Nga Agim Basha

Shyqyr që e kapa Shpëtimin për pak çaste në kafën e Benit..... Edhe sot që e takova, ai ishte përsëri i angazhuar me problemet e gazetarisë investigativ e..... Është merak gjithmonë... Një jetë në fushë të gazetarisë, tani është e pamundur që atë ta gjesësh jashtë kësaj fushe....Sapo që e hap bisedën me të, fjala shkon tek gazetaria, tek televizioni.... Me të ke se çfarë të thuash.... Aq shumë për tri dekadat të paktën së bashku me të,.... Në gazetari.... E kemi filluar që herët atëherë kur nuk pipëtinte miza* në gjuhën shqipe këtu në Athinë....Të kuptohemi, (jo për të bërë të fortin...) por për të inkurajuar të drejtën... Për të mbështetur komunitetin e math të shqiptarëve... që fatkeqësisht, ende nuk ka harritur të kompaktësohet, të paktën në zgjedhjet e dhura... Atëherë,në ato kohë kur ishim të rinj dhe kishim ëndërra të mëdha përpara.... Koha bën të sajën, ecën dhe ne bashkë me të, u thinjëm... Por Shpëtimi mbetet përsëri aktiv, energjik sikur të jetë dita e parë e tij në Gazetari....Gazetarët, mund të mbeten si një ishull i vetmuar nëse nuk e kanë përkrahjen e gjerë të komunitetit...Në komunitetin shqiptar në greqi, kjo gjë mungon... Por, pasojat nuk janë një gjëmë le të themi për gazetarinë, përkundrazi, më shumë ato rëndojnë vetë këtë komunitet... Gjithsesi... Shpëtimin, I uroj shëndet dhe vullnet në misjonin e vështirë të gazetarit.... Gjithashtu urimet më të mira për të gjithë ju, miqtë e mi!



Klodoaldo Lamçe

Lind pyetja, po ku shtrihet Labëria ? Labëria është lart e më lart, atje ku emri i saj lidhet me lavdinë. Është qendrisur edhe leçuar nëpër deftere, me këngët, me vajet, me luftrat shekullore dhe trimat pa fund. Unë për vete dua ta navas sipas meje, por me përgjegjësi për të thënë disa gjëra. Për të ardhur deri në Labëri, ka disa rrugë : Tepelenë - Bënc - Lekdush - Progonat - Gusmar - Rexhin - Nivicë. Nga bregdeti Qeparo, Kuç dhe rruga tjetër duke u futur nga Lumi i Vlorës - Kuç - Progonat - Gusmar - Rexhin - Nivicë. Nga Tepelena në Dukaj, Salari, Nivicë e me radhë në gjithë fshatrat e Kurveleshit. Kisha mbledhur mendje se do isha pranë foles sime të quajtur Labëri, fundjava e një jave të stërlodhur Marsi më gjeti lart. U nisa për te ndalesa ime e parë,



siç bëj ngahera sa vij në Labëri, gjëndesha te Runajt e Nivicës, një mendim aty - këtu ishte një rrugë për në Llufl. Llufa e bredhave dhe ujit qelibar të kulluar. Ishte java kur bëja dokumentar edhe sportin drejtpërdrejt për teleshikuesit. Tek rruftisja një filxhan kafe turke edhe natyrisht duke hedhur nga një kup uji të bekuar. Nga fjala në fjalë nga historia në histori, koha ikën tek Runajt, marë makinën dhe drejtohem për në llufë. Gjatë rrugës, më vjen në mendje një petanik nga zona e Labërisë dhe për të kaluar një fundjavë mes natyrës dhe ushqimeve bio.

Siç ma kanë dëftuar : Një petanik ka 7 shtresa, i ndarë në 15 racione. Racionet janë në madhësinë e një pice. Përbërësit janë : Miell gruri, djath i bardhë, gjalp dhe erëza të ndryshme e veëanërisht dhjasmë. Rekomandohet të hahet i ngrohtë sa del nga saçi.

Makina ecte leht mbi çakull e stërrall, më vinte në mend poezia e Naim Frashërit :

Gjithë ç'jemi shqipëtarë,
Jemi një fis e një farë,
Kemi të tërë një shpresë,
Një gjak, një gjuhë, një besë,
Si i përhumur më del një Nëno

përpara, më takoi dhe pa më dhënë dorën akoma më tha: Ku vete o derman në mes të natës, si lugat. Të gjej veten në paqe edhe qetësin, ju dukë e çuditshme edhe iku, po s'kishte çudi por unë doja qetësi, larg nga të gjithë. Mbrita tek Jaho Xhebro në lluf, më sakt tek Bujtina "Hadër Xhebro". Bujtina ka 6 dhoma, është një biznes familjar. Parkoj makinë, ndez një cingar edhe vete tek lokali :Si veni ? Mirë jeni a qysh jeni ? Keni marë, rrogat apo paran ? Bëj qef, se kështu bëjm edhe ne, në Tiranë. Kur dëgjohe një zë : Mbushja Nipçes një, e ka nga unë... Opo dale , sa erdha mbushe një. Pije se të bën shafajet... Shëndet të gjithëve. Me rrugën e re do keni punë, do keni para, do shtohen turistët, do lëvizin njerëzit, mallrat etj. Zhvillimi i krahinës do të jetë i madh,



Vendi nuk më mbate, mora bllokun e Regjisorit edhe fillova një axhend edhe çfarë do bëja e kë do takoja. Bëra rreth 20.000 hapa nëpër terminal derisa plotësova pazëllin e Përtej Oqeanit. Mendimi mu pre, sepse ishte thirrja e imarkimit për në një airbus 350 900, I Lufthansa Airlines. Pasi u nisëm për një pudhëtim pre 9 orë e 45 minuta, mora bllokun edhe fillova të hedh mendimet, ato orë ikën me shpejtësi por edhe duke lexuar për Fan S Noli e Konicën. Me të mbritur në Chicago rreth orës 12:00 Amerikane edhe 19:00 me orën Shqiptare, u nisa për tek zyrat e "Vatra Chicago". Vatra është një organizatë jofitimprurëse që synon të bashkojë komunitetin Shqiptar në Chicago dhe të ndihmojë anëtarët e saj. Qëllimi është promovimi i bashkëpunimit dhe njohjes të anëtarëve



për tu dhënë fuqi, që zëri i tyre të dëgjohe mbi çështje te rëndësishme ose jo. Mbete i mahnitur me pritjen, dashurin për një tjetrin, sa bënin për njëri tjetrin. Vatra e Chicagos, u themelua më 4 Shkurt 2023. Aty bëjnë pjesë : Patriotë, veprimtarë, shkrimtarë, aktivistë,



biznesmenë dhe studentë . Qëllimi është për ti dhënë një frymë edhe më të fuqishme përpjekjes shqiptare në Amerikë.

Dega e Vatrës në Chicago drejtohet nga:

Mirela Kanini - kryetare,
Ernest Nasto - nenkryetar,
Bledi Stefa - shef kabinetit,
Ardian Ruci - sekretar,
Daniela Kaja - arketare



Kryesia përbëhet nga: Olsi Taho, Artan Nati, Angelo Maranda, Shkelzen Cakeri dhe Kastriot Fetahu. Qëllimi kryesor është bashkimi i komunitetit tonë dhe forcimi i identitetit shqiptar e vlerave tona kombëtare. Mësoj se Vatra është grupimi patriotik më serioz në të gjitha diaspora shqiptare. Është historia, identiteti dhe krenaria e shqiptarëve në Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Sa më shpejt kalon koha, kuptoj se ata Përtej Oqeanit nuk janë pak janë shumë shumë, plotë të formuar edhe të shkolluar. Nga më të mirët, ata janë Vatra e Nolit dhe Konicës.



Ndaj duhen ruajtur kontakte me ta, për të provomuar vëndi edhe bukurit e saj por dhe ata Përtej Oqeanit. Ne kemi Diellin edhe Vatrën, si pasur nga të parët tanë. Ne i kemi haruar edhe nuk kujtuar, askush nuk shkruan për ata. Ata bëjnë me 100 qindra aktivitete, me ato mundësi që kanë. Janë e ardhmja jonë atje...



Në fund të luftës të parë botërore, në qershor te vitit 1917, VATRA ndërmori Fushatën Historike për Shpëtimin e Shqipërisë, me këto fjalë të Fan S Nolit : "Mbahu neno, mos kij frike. Se ke djemte ne Amerike!"

Kur Amerika hyri në luftë në 1917, Fan Noli, i kërkoi Presidentin Wilson, të mbrojë Pavarësinë e Shqipërisë të 1912 - Presidenti Wilsoni e mbajti, sot nuk do të kishim Shqipëri. Ne, të gjithë bashkë duhet të krijom lidhje të forta me ata Përtej Oqeanit dhe me ndjenja patriotike, të vijm për të vizituar Shqipërinë nga Veriu në Jug. Duhet të kemi një organizimin në Amerikë por jo vetëm, ku në çdo Shtet edhe qytet të hapim shkolla për të mësuar gjuhën shqipe.



Ndjenja kombëtare ka rrënjë të forta në zemrat shqiptare; dhe ndonëse më ndonjë rast, moskokëçarja dhe moskuptimi i shqiptarëve gati na shkurajojnë dhe shkurajojnë gjithë miqtë e tyre të vërtetë, duhet pranuar se ndjenja kombëtare atyre nuk u mungon, por u mungon ajo vetëdije e qëruar, aq e domosdoshme për përparimin. (Albania, nr 2, 14, 15-30 qershor 1898) Faik Konica.



Shkelqim Hajno

DITË JANARI NË KALANË E ALI PASHË TEPELENËS

Sa më shumë lexon për Ali Pashën, aq më tepër del në pah figura komplekse, e tij. Si tiran? Po edhe si hegjemoni i parë shqiptar sikurse kanë vënë re me të drejtë, me studime të thelluara autorë të respektuar si Dorian Koçi, Irakli Koçollari, etj. Këtu fryjnë erërat e historisë dhe legjendave.



Në mjediset dhe objektet e trashëguara deri sot prej kohës së shkëlqimit të Pashallëkut të madh, ke ndjesitë se ende pranë këtyre mureve dhe rënojave, ndihen si pëshpërma, zërat e kështjellarëve, konsujve të huaj, dërgatave, agjentëve, banorëve myslimanë, të krishterë dhe hebrenj, femrave bukura të haremit dhe roje, roje, sa shumë roje... Është ditë dimërore janari pa shi. Në mjediset e brendshme të Kalasë së Pashait në Janinë, mund të fiksosh përtej pluhurit të historisë, objektet kryesore/Monumente kulture/ në ruajtje maksimale.

Këtu sheh vizitorë nga çdo vend i botës, studjues, historianë njerëz të letrave, etj., që intrigohen rreth kësaj figure unike dhe epokës së tij.

PORTA. XHAMI. MUZE. MUZEU BIZANTIN. THESARI. KISHA E

SHËN ANARGJIIRIT. XHAMIA E ASLLAN PASHËS. BIBLIOTEKA TURKE. BANJAT BIZANTINE, HAMAMI. XHAMIA E FETIQESË. KOMPLEKSE NDËRTIMORE. Dhe ai, VARRI i famshëm i tij. Të rinj, familje me fëmijë, të dashuruar, nxënës, studentë, të gjithë vizitorë të zë syri gjithandej në kala si në një pelegrinazh turistik.

Si njeri, që kam lindur dhe kam kaluar fëmijërinë pranë mureve të kalasë tjetër të Aliut në vendlindjen e tij në Tepelenë, përmbi Vjosë; pak ditë më parë e vizitova atë Kala.

Pashë që po realizohej më në fund një tjetër projekt rehabilitues, në mjediset e brendshme të Kalasë, këtij kompleksi monument kulture i kategorisë së parë.



Uroj, që të përfshihet këtë herë edhe Muzeu i munguar i Aliut, që qytetin ku sot, ka vetëm një bulevard kryesor me emrin e tij por, jo një muze. Dhe ai, quhet Ali Pashë Tepelena (jo: Ali Pashë Janina). Duke menduar këto, para një monumenti kulturi në Kalanë e Ali Pashë Tepelenës në Janinë, befas, ngrita sytë nga qielli se nisën pikat e shiut dhe , thashë me vete: ZOT, boll kemi vuajtur nga varfëria e mendimit dhe vizionit !...

KUR POLITIKA U NGATËRRUA ME KOPENË

Marrë nga ide plus

Një bari u befasua nga një makinë e re që ndaloi pranë kopesë së tij dhe një i ri i veshur mirë doli dhe i tha: Nëse do t'ju tregoja sa kafshë janë që kujdeseni, a do të më jepnit një? Bariu u habit dhe u përgjigj: Po. Kështu i riu nxori një kompjuter të vogël dhe e lidhi me celularin, hyri në internet dhe hapi një faqe, ku mori një shërbim pozicionimi satelitor (GBS), më pas hapi një kërkim për bankën e tij dhe e kontrolloi. Ju keni 641 dele, dhe kjo ishte e vërtetë. Bariu i tha: Ju lutemi zgjidhni delen që ju pëlqen. I riu doli nga makina e tij dhe qëndroi pezull mes tufës, më pas futi kafshën e zgjedhur në bagazhin e makinës. Atëherë bariu i tha: Nëse do të mund ta dija natyrën dhe llojin e punës suaj, a do të ma kthenit delen time? I riu ra dakord. Bariu i tha: Ju jeni një politikan, i riu u habit dhe tha: Kjo është e vërtetë, por nga e dinit këtë! ?

Bariu i tha: E thjeshtë

E para: Ndërhyrja në pronën e të tjerëve dhe lakmia për çdo thërrime dhe kafshatë është një karakteristike e veçantë e juaj, sepse keni ardhur këtu pa ju kërkuar askush! Së dyti: Pretendimi se di ndonjë gjë. Argument është se ju nuk e dinit dallimin midis një qeni dhe një dele, ju pëlqeu vetëm qeni midis këtyre deleve. Ndaj ju lutem nxirreni qenin tim nga bagazhi i makinës suaj sepse nuk është dele!





Zaho Balili

POEZI



Nevjola Lila

Ç'u bënë ata djem

Pse s'më thua këngë me gojë
Ç'të ka gjetur Shqipëri
Ç'i bëre këngët e jetës
Vetëm këngë vdekje di?

Ku mi ke burrat e parë
Ku ma ke Ali Pashan
Që osman vriste me pallë
Të dy varret dot se mbanë

Ku e ke palcën e djemve
Ku është gjaku i gjakut tënd
Mbetur detesh e stëreve
Dhe lotin fshirë me mëngë

Këputa një fije bari
Mu dhimbs, në dorë më mbeti
Ti Shqipe si zanë mali
Pse nise ç'të rriti djepi

Kemi diell, kemi hënë
Kemi babë, kemi nënë
Kemi majën, kemi rrënjë
Këtu të jemi të tërë

Udhët e Evropës

Mu tret syri duke pritur
Edhe gjiri larë lot
Kjo kohë kë s'ka goditur
Kë s'goditi, le ta thotë

S'u mbyllka qerpiku i kombit
Shqipëria nuk ka gjumë
Nënat, tjerrin dhembshurinë
Etërit, djegin duhan shumë
Mërmërisin nëpër buzë
Emra vendesh të pa njohur
Herë s'ua thonë emrat kurrë
Herë ua thonë të merakosur

Kush i njeh udhët e botës
Bijtë që ikin në këmbë
Jo zyrtarët e Evropës
Ç'më del ashpër kjo këngë

Ah! Moj Tepelenë

Moj e shtrenjta Tepelenë
Vetull përmbi,
Vjosë ngritur
Nuse e bukur mbi beden
Buzë qeshur, ballë ndritur

Vlora zjarr e çikë stërralli
Të dërgon zën' e Selamit
Kur Gjermani nga istikami
Me gjak skuqur xhamadani

Këto gërxhe, këto shkrep
Cilin nga trimat nuk panë
Të falsin, për karadakun
Të flasin, për Mustafan

Maja e maleve lartë
Me Asim Zenelin ngjajnë
Me Abaz Shehun furtunë
Me Nimete Progonan

Ishin lule, mbeten ujë
Treqind zemra Labërie
Gjaku i tyre për liri
Emrin dhënë në histori

Labëri, o këngërrënjë

Mali mbi male të lartë
Hijerëndë këndrevicë
Të dy me çipinin bashkë
I bëni djemtë me çikë

I rritët djemtë dhipllarë
Një jetë mbinë mbi kalë
Vetëtimë qiellin çarë
Hundë më hundë me
pashallarë

Lumi Vlorës, mor i sertë
Ti që di e rrit Gjolekë
Që më mbajte Bilbilentë
Çdo shtëpi e bëre çetë

Kurvelesh, majë më majë
Mblidhen djemtë nga kohët,
tutje
Jataganë e pallë larë

KURVELESHI

Në majat ku fryn era me mall,
Ku malet me qiellin janë të gjallë,
Kurveleshi, ti je frymëzim,
Një këngë e lashtë që nuk humbet në
agim.

Udhë të ngushta, të mbuluara me
gur,
Historia jote në çdo hap na shfaqet
këndëshumë,
Kullat që heshtin, por flasin me zërin
e tokës,
Janë kujtimet tona, trashëgimi e
gjakut të fortës.

Burime të kristalta që rrjedhin për-
jetë,
Si zemra që rreh, si fjala e shenjtë,
Në të gjejmë paqe dhe përçafim,
Kurveleshi, djepi i shpirtit tonë të
lirë.

Ah, erën e luleve mos ma harro,
As zërin e pyllit që natën ndriçon,
Se çdo degë e jote mban mallin e
gjyshërve,
E çdo gurë na kujton sakrificën e të
parëve.

O Kurvelesh, ylli që rri gjithmonë në
qiell,
Na udhëhiq me dritën tënde të
ngrohtë, pa frikë,
Se në çdo hap të jetës, mes rrahjeve
të zemrës,
Ti je ai që na kthen te vërë e qetës.

Çmime dhe Vlerësime, që i janë akorduar ndër vite poetit, Zaho Balili

1. Çmimi i parë në Takimin e Kulturës Masive të ndërmarrjeve të qytetit të Tepelenës (1980), me grupin amator të S.M.T.
2. Çmimi i parë në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës (1988) me këngën "Flaka mbuloi fshanë", kënduar nga grupi i Hormovës.
3. Vlerësim i veçantë në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës (1988) me këngën "13 male me këmbë", kënduar nga grupi i të rinjve të Rexhinit.
4. Vlerësim i veçantë në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës (2000) me këngën "Baladë për komisar Arben Zylyftari", kënduar nga grupi i Hormovës.
5. Në vitin 2002, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë i akordon titullin: "Personalitet i Shquar në Fushën e Artit dhe Kulturës" si këngëtar i shquar i këngës polifonike të trevave të jugut.
6. Më 16 Korrik 2012, Presidenti i Republikës, z. Bamir Topi, i akordon urdhrin "Naim Frashëri" i Argjendit me motivacionin: "Për kontribut të shquar në zhvillimin e folklorit të zonës së Tepelenës, veçanërisht me grupin e Hormovës, si drejtues i spikatur dhe rapsod."
7. Më 31 Tetor 2014, Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë Tepelenë, z. Tërmet Peçi, i akordon titullin "Qytetar Nderi", me motivacionin: "Për kontributin e vlefshëm në zhvillimin e folklorit të zonës së Tepelenës, veçanërisht me grupin e Hormovës, si drejtues dhe si rapsod."
8. Më 24 Tetor 2015, Shoqata Vatra Labe, Athinë, i akordon titullin "Çertifikatë Nderi" me motivacionin: Shoqata Vatra Labe, i jep këtë fletë nderi pas vdekjes, krijuesit, rapsodit, këngëtarit dhe themeluesit të disa grupeve labe, poetit Zaho Balili. "Për ruajtjen, forcimin, zhvillimin dhe përhapjen e këngës polifonike labe, dhe për kontributin e madh të dhënë përmes krijimtarisë së tij në folkloristikë dhe polifoni."
9. Çmimi i parë në Festivalin e Tetë Ndërkombëtar të Polifonisë Shqiptare "Bylis" (22 Shtator 2018) me këngën "Atje kemi Labërinë", kënduar nga grupi Lotë Kurbeti.

NJOFTIM

Mirëpresim shkrimet tuaja në adresën e e-mail:
zerikurveleshit@gmail.com dhe
në whatsapp në tel: 068 40 96 709.
Gazetën mund ta lexoni në linkun:
<https://zerikurveleshit.al/>